

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe trajtimit financiar për sportistët dhe trajnerët që përfaqësojnë Klubin Shumësportësh Teuta në kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare për vitin 2026 “

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe trajtimit financiar për sportistët dhe trajnerët që përfaqësojnë Klubin Shumësportësh Teuta në kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare për vitin 2026 “

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet nëpërmjet takimit publik, mbledhjes së sugjerimeve, komenteve dhe rekomandimeve.

Sugjerimet/komentet/rekomandimet janë të mirëpritura deri më datë 2 Korrik 2026, në adresën e emailit:

Daniela.Murataj@durres.gov.al, keshillidurres@gmail.com, migena.muhaj@durres.gov.al

Organizues :

- Administrata e Bashkisë Durrës dhe Këshilli Bashkiak

Priten rekomandime/sugjerime nga :

- Banorët e Bashkisë Durrës, profesionistë nga fusha e sportit, sportistë, trajnerë, shoqata sportive, sportdashës, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, përfaqësues të komuniteteve fetare në Durrës, grupe të ndryshme interesi etj.,

Forma e konsultimit: Nëpërmjet takimit publik, mbledhjes së sugjerimeve, komenteve dhe rekomandimeve.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik synon përfshirjen e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit, edhe atij në fushën e sportit, lidhur me “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe trajtimit financiar për sportistët dhe trajnerët që përfaqësojnë Klubin Shumësportësh Teuta në kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare për vitin 2026 “ Bashkia Durrës, në ushtrim të kompetencave të saj ligjore, vlerëson të nevojshme miratimin e një skeme mbështetëse për sportet kolektive (volejball dhe basketboll) që përfaqësojnë Klubin e Shumësporteve
------------------------------	---

	<p>“Teuta” si edhe sportistët dhe trajnerët në sportet individuale, të cilët kanë fituar vende të para, të dyta edhe të treta në nivel kombëtar.</p>
<p>Përshkrimi i çështjes.</p>	<p>Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”, të ndryshuar me ligjin nr.105/2020, datë 29.07.2020, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 15.12.2021, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërblimit dhe trajtimit të sportistëve dhe trajnerëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë” të ndryshuar, Bashkia Durrës, në ushtrim të kompetencave të saj ligjore, vlerëson të nevojshme miratimin e një skeme mbështetëse për sportet kolektive (volejball dhe basketboll) që përfaqësojnë Klubin e Shumësporteve “Teuta” si edhe sportistët dhe trajnerët në sportet individuale të cilët kanë fituar vende të para, të dyta edhe të treta në nivel kombëtar. Për garantimin e transparencës, kontrollit administrativ dhe përdorimit të rregullt të fondeve publike, mbështetja do të aplikohet për sportistë dhe trajnerë të atashuar në shoqata sportive që kanë marrëveshje përfaqësimi me të. Më gjerësisht, në këtë projektakt gjeni të përshkruar kriteret e përfitimit, dokumentat administrativë dhe kushtet për përfitimin e trajtimit financiar.</p> <p>Qëllimi është : Mbështetja e sportistëve dhe trajnerëve në sportet individuale të cilët kanë fituar vende të para, të dyta edhe të treta në nivel kombëtar.</p> <p>Vizioni është :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një mekanizëm motivues për vazhdimësinë e performancës sportive; • Një instrument nxitës për përfshirjen e të rinjve në aktivitete sportive kolektive; • Një formë vlerësimi institucional për arritjet sportive; • Një kontribut në forcimin e imazhit të qytetit në nivel kombëtar.
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresën e email-it më poshtë, brenda datës 2 Korrik 2026.</p> <p>daniela.murataj@durres.gov.al, keshillidurres@gmail.com, migena.muhamaj@durres.gov.al</p>

<p>Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me cështjen që konsultohet.</p>	<p>Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen web të bashkisë, faqja kryesore. https://durres.gov.al/category/bashkia/njoftime/ https://durres.gov.al/konsultimet-publike/</p>
<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Administrata e Bashkisë dhe Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit në bashkëpunim me KNJKP i një “Përmbledhje të rekomandimeve dhe rezultateve të plota” që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti. 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Sporteve, Rinisë dhe Komuniteteve Fetare, Klubit të Shumësportësh “Teuta”, Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Sporteve, Rinisë dhe Komuniteteve Fetare dhe Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit të çdo rekomandimi si dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 7. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 8. Monitorimi i zbatimit të tij.
<p>Data e publikimit</p>	<p>04.06.2026</p>